

# RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2020 (progresiv- 4 Muj.III-të)

**BASHKIA ELBASAN**

*Shkurt 2021*

## **Përmbajtja:**

- I. Buxheti i Bashkisë për vitin 2020 (periudha janar- dhjetor)
- II. Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për periudhën janar-dhjetor 2020
- III. Realizimi i buxhetit për 4-mujorin e III-të (vjetor), 2020
  - F1. Funksioni “Shërbime të përgjithshme publike”
  - F2. Funksioni “Shërbime të huamarrjes vendore”
  - F3. Funksioni “Rendi dhe siguria publike”
  - F4. Funksioni “Çështje ekonomike”
  - F5. Funksioni “Mbrojtja e mjedisit”
  - F6. Funksioni “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”
  - F7. Funksioni “Shëndetësia”
  - F8. Funksioni “Argëtimi, kultura dhe feja”
  - F9. Funksioni “Arsimi”
  - F10. Funksioni “Mbrojtja Sociale”

## **I. Buxheti i Bashkisë për vitin 2020.**

Detajimi i buxhetit për vitin 2020 është bërë bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, date 08.07. 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017, datë 27.4.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore“, ligjin 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020 “ si dhe VKB nr. 201, datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkise Elbasan per vitin 2020”, i ndryshuar.

Programi Buxhetor i vitit 2020 parashikonte një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale; përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; mirëmbajtjen e tregjeve të reja; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturës bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë; mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Zbatimi i Buxhetit të vitit 2020 është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës dhe mbrojtjen e mjedisit duke e kthyer Elbasanin në një qendër të përparuar social -ekonomike.

Ky dokument ka përcaktuar 34 programe dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit që i mbështet këto projekte.

Bashkia Elbasan, administron dhe menaxhon fondet, sipas 34 programeve të miratuara, si më poshtë:

1. Programi “Planifikim, Menaxhim & Administrim”
2. Programi “Çështjet financiare dhe fiskale”
3. Programi “Shërbimet e Gjendjes Civile”
4. Programi “Pagesa për shërbimin e borxhit të brëndshëm”
5. Programi “Shërbime të Policisë Vendore”
6. Programi “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”
7. Programi “Mbeshtetje për zhvillimin ekonomik”
8. Programi “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”
9. Programi “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore...”
10. Programi “Menaxhimi i infrastrukturës së ujëtjes dhe kullimit”
11. Programi “Administrimi i pyjeve dhe kullotave”
12. Programi “Infrastruktura Rrugore Vendore ”
13. Programi “Transporti publik”
14. Programi “Menaxhimi i mbetjeve”
15. Programi “Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve”
16. Programi “Programe të mbrojtjes së mjedisit”
17. Programi “Planifikimi urban vendor”
18. Programi “Strehimi”
19. Programi “Infrastruktura Rajonale Vendore ”
20. Programi “Shërbimet publike vendore”
21. Programi “Furnizimi me ujë”
22. Programi “Ndriçim rrugësh”
23. Programi “Shërbimet e kujdesit parësor”
24. Programi “Sport dhe argëtim”
25. Programi “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore”

26. Programi “Arsimi bazë (përfshirë parashkollor ”
27. Programi “Arsimi mesëm përgjithshëm”
28. Programi “Arsimi mesëm profesional”
29. Programi “Kujdesi social për personat e sëmure & aftësi të kufizuar”
30. Programi “Sigurimi shoqëror (të moshuarit)”
31. Programi “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”
32. Programi “Strehimi social”
33. Programi “Emergjencat civile”
34. Programi “Fondi rezerve dhe kontigjenca”

### **Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020, vijnë nga dy drejtime :**

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione, dhe të ardhura të trashëguara.

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja (sektoriale), transferuar Bashkisë, transfertat të kushtëzuara dhe investime nga FZSH.

**Në këtë material, në vijimësi do të gjeni të dhëna në lidhje me treguesit financiarë të monitorimit të buxhetit për vitin 2020, si për të ardhurat ashtu dhe për shpenzimet si dhe për raportet midis tyre.**

## **II. Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2020.**

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, të ardhurat të tjera dhe të ardhurat nga funksionet specifike, si shërbimi pyjor, ujitja dhe kullimi, etj. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë periudhës janar- dhjetor 2020, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, Bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të Bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal, ndikuan në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet “Zyrave me Një Ndalesë” dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në

territorin e bashkisë pranë qytetarit, ndikuan në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Politikat për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, etj. janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për rritjen e të ardhurave krakasuar me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara.

Këto politika të lehtësive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqëruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërtetuan efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që Bashkia ka arritur gjatë vitit 2020, krahasuar me vitet paraardhëse, megjithëse në kushtet e situatës së pandemisë “COVID -19”.

Situata e krijuar nga pandemia “Covid- 19” dhe masat që u ndërmorën nga qeveria në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore” (VKM nr.243, datë 24.03.2020), bënë që për muajt mars dhe prill të ndërpritej vijimi normal i procesit të arkëtimit të të ardhurave dhe tendenca të ishte në rënie.

*Për ti ardhur në ndihmë bizneseve, me vendimin e KB nr.45, datë 07.05.2020 dhe nr 55, datë 18.06.2020 është miratuar përjashtimi i subjekteve nga pagesa e tarifës për zënie e hapësirës publike, për periudhën mars- maj 2020 si dhe është miratuar ulja e nivelit të kësaj tarife për bizneset, por edhe të ardhura të munguara të taksës së fjetjes në hotel, efektet e të cilave janë reflektuar në buxhetin e vitit 2020.*

Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e Bashkisë, me Njësitë Administrative, me institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Këtë tendencë rritje e treguan arkëtimet në dy muajt e parë të vitit por edhe në muajin mars duke e krahasuar me janarin. Ndërsa periudha mars- prill pati ulje të ndjeshme të nivelit të arkëtimeve, në katërmujorin e dytë dhe tretë, si pasojë e mobilizimit të strukturave tatimore, pati një rritje të nivelit të të ardhurave, siç edhe tregohet në grafikun më poshtë, duke ndihmuar në rritjen e nivelit të realizimit të shpenzimeve të planifikuara në buxhet për vitin 2020.

Problematika në lidhje me planin e të ardhurave qëndron për një pjesë nga llojet e taksave dhe tarifave vendore. Për disa nga të ardhurat, si është taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila zë një peshë specifike të konsiderueshme në buxhet, përveçse situatës kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë. Planifikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë duke marrë në konsideratë përfundimin e PDV-ve, pas miratimit të të cilave, në fillim të vitit 2020 pritej fillimi i ndërtimeve të reja, në zbatim të planit të përgjithshëm vendor të qytetit. Pengesat dhe vonesat në hartimin e PDV-ve janë arsyeja kryesore në mosrealizimin e planit të të ardhurave nga taksa e infrastrukturës për 12- mujorin e vitit 2020.


### III. Kategorizimi i të ardhurave

- Taksat vendore:
  - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
  - Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
  - Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
  - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
  - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5 milion deri në 8 milion,
  
- Taksat e ndara
  - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë,
  - Taksa vjetore e mjeteve të përdorura,
  - Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
  - Të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale
  
- Tarifat vendore
  - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
  - Tarifa për ndriçimin publik
  - Tarifa për gjelbrimin
  - Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Elbasan
  
  - Tarifa për parkimin e mjeteve e licensuara dhe vendparkime publike
  - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
  - Tarifa për zënien e hapësirave publike
  - Tarifa nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
  
- Të ardhura të tjera:
  - Të ardhura nga gjoba
  - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhëmtime, shitja e aseteve dhe e shërbimeve etj.
  
- Të ardhura nga huaja

#### Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë, për vitin 2020 ( në mijë lekë)


| Nr. | Të ardhurat nga burimet e veta vendore  | Plan 2020        | Realizimi janar-gusht 2020 | Realizimi vjetor % |
|-----|---|------------------|----------------------------|--------------------|
| 1   | Të ardhurat nga taksat vendore          | 600,734          | 314,194                    | 52 %               |
| 2   | Të ardhura nga taksat e ndara           | 76,000           | 99,604                     | 131 %              |
| 3   | Te ardhurat nga tarifat vendore         | 393,746          | 283,333                    | 72 %               |
| 4   | Te ardhura te tjera                     | 251,072          | 89,353                     | 36 %               |
| 5   | Te ardhura nga donacionet (jash limiti) | 0                | 23,611                     |                    |
|     | <b>TOTALI</b>                           | <b>1,321,552</b> | <b>810,095</b>             | <b>61%</b>         |

**Te ardhurat e realizuara, sipas kategorive, per periudhen janar- dhjetor 2020**



|                   | janar  | shkurt | mars   | prill  | maj    | qershor | korrik  | gusht  |
|-------------------|--------|--------|--------|--------|--------|---------|---------|--------|
| Te ardhura fakt : | 38,466 | 51,413 | 44,201 | 27,936 | 39,185 | 54,991  | 168,139 | 58,009 |

| shtator | tetor   | nentor | dhjetor |
|---------|---------|--------|---------|
| 111,268 | 100,755 | 51,684 | 64,048  |



Realizimi i të ardhurave për periudhën janar - dhjetor 2020.

*Në mijë lekë*

| Nr        | TE ARDHURA                              | Plan<br>VJETOR<br>2020 | Fakt<br>janar-dhjetor<br>2020 | Krahasimi në<br>% me planin<br>Vjetor 2020 |
|-----------|---|------------------------|-------------------------------|--|
| <b>A</b>  | <b>TE ARDH.VENDORE (I+II+III+IV+V)</b>  | <b>1,321,552</b>       | <b>786,484</b>                | <b>60%</b>                                 |
| <b>I</b>  | <b>TAKSA VENDORE</b>                    | <b>600,734</b>         | <b>314,194</b>                | <b>52%</b>                                 |
| 1         | Taksa biznesi vogel                     | 50                     | 0                             | 0  |
| 2         | Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV      | 8,575                  | 8,514                         | 99%  |
| 3         | Taksa mbi ndertesat                     | 217,270                | 168,762                       | 78%  |
| 4         | Taksa mbi token bujqesore               | 26,990                 | 16,319                        | 60%  |
| 5         | Taksa mbi truallin                      | 26,300                 | 25,393                        | 97%  |
| 6         | Taksa mbi veprim. e sherbimit hotelier  | 6,899                  | 2,670                         | 39%  |
| 7         | Taksa e ndikimit ne infrastrukture      | 313,900                | 91,925                        | 29%  |
| 8         | Taksa e tabelës                         | 750                    | 611                           | 81%  |
|           | <b>TAKSAT E NDARA</b>                   | <b>76,000</b>          | <b>99,604</b>                 | <b>131%</b>                                |
| 9         | Taksa mbi kalimin e pronësise           | 6,000                  | 6,868                         | 114%                                       |
| 10        | Taksa vjetore e mjeteve te perdorura    | 60,000                 | 62,742                        | 105%                                       |
| 11        | Renta minerare                          | 3,000                  | 458                           | 15%  |
| 12        | Tatimi mbi te ardhurat personale        | 7,000                  | 29,536                        | 422%                                       |
| <b>II</b> | <b>TE ARDHURA NGA TARIFAT</b>           | <b>393,746</b>         | <b>283,333</b>                | <b>72%</b>                                 |
| 1         | Tarife per zenien e hapës.publike       | 27,921                 | 23,548                        | 84%  |
| 2         | " pastrimi                              | 159,220                | 126,575                       | 79%  |
| 3         | " gjelberimi                            | 39,300                 | 27,351                        | 70%  |
| 4         | " ndricimi                              | 69,280                 | 43,436                        | 63%  |
| 5         | " miremb. infrastruk. ne Nj.Adm.        | 4,640                  | 2,073                         | 45%  |
| 6         | " reklame                               | 6,500                  | 7,115                         | 109%                                       |
| 7         | " veterinare                            | 1,500                  | 440                           | 29%  |
| 8         | " parkim automjete                      | 29,450                 | 7,698                         | 26%  |
| 90        | " embleme bashkie                       | 100                    | 52                            | 52%  |
| 10        | " regjistrimi                           | 5                      | 10                            |  |
| 11        | " leje, certificate transporti          | 2,000                  | 1,673                         | 84%  |
| 12        | " autoriz, tregetim karb.+lende djegese | 5,000                  | 2,600                         | 52%  |
| 13        | " leshimin e vertetimeve                | 2,350                  | 1,791                         | 76%  |
| 14        | " dokumenta ankandi                     | 5                      | ,0                            |  |
| 15        | " autoriz., zgjatje orari ,etj          | 1,100                  | 2,149                         | 195%                                       |
| 16        | " formulare te pastrehe                 | 25                     | 10                            |  |
| 17        | " sherbimi karrotresh                   | 480                    | 30                            | 6%   |
| 18        | " leje perdorimi per objekte biznesi    | 1,000                  | 1,608                         | 161%                                       |
| 19        | " leje perdorimi per banim              | 1,000                  | 702                           | 70%  |
| 20        | " certifikim relievi                    | 700                    | 728                           | 104%                                       |
| 21        | " deklarim paraprak                     | 1,700                  | 790                           | 46%  |
| 22        | " trajt.fasades ndertesave              | 1,600                  | 1,458                         | 91%  |
| 23        | " aplikim leje zhvillimi                | 300                    | 0                             | 0  |
| 24        | " hartim PDV mbi pronen                 | 300                    | 1,807                         | 602%                                       |
| 25        | " plan rievimi                          | 200                    | 0                             | 0%   |
| 26        | " shqyrtim dok.leje ndertimi            | 2,600                  | 1,725                         | 66%  |
| 27        | " kantier ndertimi objekt mbi 4 kat     | 7,000                  | 4,745                         | 68%  |

|            |  |                  |                |             |
|------------|--|------------------|----------------|-------------|
| 28         | " lëshimin e dok.nga arkiva                          | 200              | 113            | 57%         |
| 29         | " rrjetin e tubacion.ujrave bardha                   | 2,200            | 2,197          | 100%        |
| 30         | " rrjetin e tubacion.ujrave zeza                     | 290              | 283            | 98%         |
| 31         | " sherbimi per rrjetin kabllor                       | 4,000            | 607            | 15%         |
| 32         | " uji pijshem  | 100              | 63             | 2%          |
| 33         | " ndotjes mjedisit                                   | 21,680           | 18,066         | 83%         |
| 34         | Detyrim I prapambetur (tarife kazino)                |                  | 1,890          |             |
| <b>III</b> | <b>TE ARDHURA JO-TATIMORE</b>                        | <b>168,089</b>   | <b>36,892</b>  | <b>22%</b>  |
| 1          | Qera objekti   | 1,484            | 1,177          | 79%         |
| 2          | Qera trualli (operatore telefonike)                  | 2.143            | 2,377          | 111%        |
| 3          | Qera toke bujqesore                                  | 500              | 204            | 41%         |
| 4          | Qera toke pyjore                                     | 9,162            | 2,810          | 31%         |
| 5          | Gjoha ndertimi                                       | 2,000            | 1,020          | 51%         |
| 6          | Gjoha biznesi  | 9,800            | 8,312          | 85%         |
| 7          | Te ardhura nga legalizimet                           | 98,000           | 20,725         | 21%         |
| 8          | Te ardhura nga shitja e asetëve (FK)                 | 45,000           | 0              | 0%          |
| 9          | Te ardhura nga privatizim banese                     |                  | 267            |             |
| <b>IV</b>  | <b>TE ARDHURA INSTITUCIONET</b>                      | <b>69,643</b>    | <b>40,932</b>  | <b>59%</b>  |
| 1          | <b>Qendra Ekonomike e Arsimit</b>                    | <b>54,277</b>    | <b>23,677</b>  | <b>44%</b>  |
|            | te ardhura nga Cerdhet                               | 10,454           | 3,974          | 38%         |
|            | te ardhura nga kopeshtet                             | 34,848           | 11,838         | 34%         |
|            | Te ardhura nga qerate                                | 8,975            | 7,865          | 88%         |
| 2          | <b>Te ardhura Sport Klubi</b>                        | <b>816</b>       | <b>758</b>     | <b>93%</b>  |
|            | Qera objekti   | 816              | 758            |             |
| 3          | <b>Qendra e Artit</b>                                | <b>850</b>       | <b>183</b>     | <b>22%</b>  |
|            | Te ardhura nga biletat                               | 550              | 103            | %           |
|            | Te ardhura okupim salle                              | 300              | 80             | %           |
| 4          | <b>Qendra e Trashegimise Kulturore</b>               | <b>100</b>       | <b>25</b>      | <b>25%</b>  |
|            | Te ardhura Trashegimia Kulturore                     | 100              | 25             |             |
|            | Te ardhura Biblioteka                                | 0                |                |             |
| 5          | <b>Agjensia e Sherbimeve Publike</b>                 | <b>6,100</b>     | <b>8,021</b>   | <b>131%</b> |
|            | Te ardhura sherbimet publike                         | 100              | 56             | 56%         |
|            | Te ardhura M.Varreza                                 | 6000             | 7,965          | 133%        |
| 6          | <b>Banesat Sociale me Qira</b>                       | <b>7,500</b>     | <b>8,268</b>   | <b>110%</b> |
|            | Te ardhura nga qirate                                | 7,500            | 8,268          |             |
| <b>V</b>   | <b>TE ARDHURA NGAFUNKSIONET SPECIFIKE</b>            | <b>13,340</b>    | <b>11,529</b>  | <b>86%</b>  |
| 1          | Te ardhura nga Sherbimi Pyjor                        | 8,780            | 5,835          | 66%         |
| 2          | Te ardhura Ujitja dhe Kullimi                        | 3,560            | 4,337          | 122%        |
| 3          | Te ardhura nga sherbimi MNZSH                        | 1,000            | 1,357          | 136%        |
|            |  |                  |                |             |
| <b>B</b>   | <b>TE ARDHURA JASHT LIMITIT</b>                      |                  | <b>23,611</b>  |             |
| 1          | Taksa e akteve dhe pulles (gj.civile agjent tatimor) |                  | 432            |             |
| 2          | Grant nga Keshilli I Qarkut                          |                  | 900            |             |
| 3          | Donacione  |                  | 22,279         |             |
|            |  |                  |                |             |
|            | <b>TOTALI I TE ARDHURAVE :</b>                       | <b>1,321,552</b> | <b>810,095</b> | <b>61%</b>  |



Zërat ndikues me mosrealizim të ndjeshëm janë : taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila zë një peshë të konsiderueshme në planin e të ardhurave, siç thamë edhe më lart, shkak kryesor i mosrealizimit është mungesa së PDV-ve, të cilat janë në fazën e hartimit dhe më pas miratimit të tyre; taksa e shërbimit hotelier, në këtë rast mosrealizimi ka ardhur për arsye të mosfrekuentimit nga klientët, për shkak të situatës së pandemisë COVID-19; taksa mbi tokën bujqësore, për arsye edhe të mungesës së informacionit nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën me taksapaguesin; po kështu me mosrealizim janë taksa mbi ndërtesat dhe renta minerare.

Nga tarifat dhe të ardhura të tjera jo tatimore, të cilat janë me mosrealizim, përmëdim : tarifën për parkim automjete, tarifën veterinarë, tarifë mirëmbajtje infrastrukturë në njësitë administrative, tarifën e ndriçimit, gjelbërimit, për zënien e hapësirës publike, tarifa të urbanistikës, të ardhurat nga gjobat e ndërtimit, qera tokë pyjore, qera tokë bujqësore, etj., informacion të cilin e merrni nga tabela e mësipërme.

Në zërat me mosrealizim do të veçonim të ardhurat nga legalizimet të cilat zënë një vënd të rëndësishëm në planin e të ardhurave dhe për pasojë kanë dhënë një efekt të ndjeshëm në mosrealizimin e planit të investimeve në zonat informale.

Ndër zërat kryesorë të cilët janë me tejkalim në krahasim me planin vjetor 2020 janë : taksa mbi kalimin e pronësisë (114 %), taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura (105%) dhe tatimi mbi të ardhurat personale i cili është katërfishuar në krahasim me planin, meqenëse janë përfshirë të ardhurat nga vitet e kaluara, transferuar njësisive vendore nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga tarifat dhe të ardhura të tjera jo tatimore përmëdim : tarifë për reklamë, tarifa të urbanistikës, të ardhura nga ujitja dhe kullimi, qera trualli, etj

- Në total, plani i të ardhurave nga taksat dhe tarifat, për vitin 2020 (progresiv 4 mujori i III-të), është realizuar në masën 61 %.

- Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qëndrore, për vitin 2020, janë :

|  |                   |
|--|-------------------|
| 1. Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore                       | 786,484 mijë lekë |
| 2. Të ardhura nga donacione  | 23,611 “ “        |
| 3. Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar                       | 695,697 “ “       |
| 4. Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike)               | 418,637 “ “       |
| 5. Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar                         | 2,228,241 “ “     |
| 6. Të ardhura të trashëguara nga viti 2019 (të ardh.veta + grante) | 218,760 “ “       |

**Gjithsej : 4,371,430 mijë lekë**

- Krahasuar me të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat vendore zënë 18,5 % të tyre.

### III. Realizimi i buxhetit për 4-mujorin e III-të të vitit 2020 (vjeter).

Realizimi i buxhetit të 4-mujorit të III-të 2020 është bërë duke respektuar ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimin Plotësues i Ministrise se Financave Nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, ligjin 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, si dhe VKB nr.201, datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkise Elbasan per vitin 2020”, me ndryshime, VKB nr.35, datë 31.03.2020 dhe nr.52, datë 25.05.2020, pikal, “Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2020” dhe VKB nr.70, datë 28.07.2020 “Rishikim i buxhetit në zbatim të vendimeve të KB, për disa shtesa dhe ndryshime në paketën fiskale të vitit 2020”.

Shpenzimet e buxhetit për periudhen janar- dhjetor 2020, nga të gjitha burimet e financimit, arritën në 4 088 917 mijë lekë, me një nivel realizimi prej 82 %.

- *Raporti i shpenzimeve të përgjithshme në krahasim me të ardhurat e përgjithshme është 93,5 % (4,088,917 mijë lekë shpenzime të përgjithshme/4,371,429 mijë lekë të ardhura të përgjithshme).*

*Realizimi i buxhetit sipas programeve buxhetore :*


| Nr Prog. | PROGRAMI  | 000/lekë         |                  |                      |
|----------|---|------------------|------------------|----------------------|
|          |   | Plan vjetor 2020 | Fakt vjetor 2020 | Realizim vjetor ne % |
| 01110    | Planifikim, Menaxhim & Administrim              | 421,945          | 341,447          | 81%                  |
| 01120    | Çështjet financiare dhe fiskale                 | 67,314           | 61,125           | 91%                  |
| 01170    | Shërbimi i gjendjes civile                      | 25,648           | 24,910           | 97%                  |
| 01710    | Shërbimi i borxhit                              | 120,336          | 117,111          | 97%                  |
| 03140    | Shërbime të Policisë Vendore                    | 29,392           | 26,602           | 91%                  |
| 03280    | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile         | 87,002           | 49,597           | 57%                  |
| 04130    | Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik              | 1,805            | 1,709            | 95%                  |
| 04160    | Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi  | 4,786            | 0                | 0%                   |
| 04220    | Shërbimet bujqësore, inspektimi, sig. ushqimore | 24,869           | 12,342           | 50%                  |
| 04240    | Menaxhimi infrastrukturës ujitjes dhe kullimit  | 124,691          | 117,796          | 94%                  |
| 04260    | Administrimi i pyjeve dhe kullotave             | 56,554           | 14,803           | 26%                  |
| 04520    | Infrastruktura rrugore vendore                  | 381,010          | 168,605          | 44%                  |
| 04570    | Transporti Publik                               | 54,718           | 32,958           | 60%                  |
| 05100    | Menaxhimi I mbetjeve                            | 149,247          | 90,476           | 61%                  |
| 05200    | Menaxhimi i ujrave të zeza                      | 5,998            | 0                | 0%                   |

|              |  |                  |                  |            |
|--------------|--|------------------|------------------|------------|
| <b>05320</b> | Programe te mbrojtjes se mjedisit            | 8,418            | 8,179            | 97%        |
| <b>06140</b> | Planifikimi Urban Vendor                     | 3,300            | 963              | 29%        |
| <b>06190</b> | Strehimi                                     | 22,267           | 22,213           | 100%       |
| <b>06220</b> | Infrastruktura rajonale vendore              | 33,147           | 33,147           | 100%       |
| <b>06260</b> | Sherbime publike vendore                     | 247,815          | 169,263          | 68%        |
| <b>06330</b> | Furnizimi me uje                             | 2,778            | 0                | 0%         |
| <b>06440</b> | Ndriçim rrugësh                              | 140,199          | 112,664          | 80%        |
| <b>07220</b> | Sherbimet e kujdesit pasesor                 | 960              | 852              | 89%        |
| <b>08130</b> | Sport dhe argetim                            | 49,938           | 38,644           | 77%        |
| <b>08220</b> | Eventet artistike dhe kulturore              | 73,456           | 55,686           | 76%        |
| <b>09120</b> | Arsimi baze&parashkollor                     | 579,602          | 433626           | 75%        |
| <b>09230</b> | Arsimi i mesem pergjithshem + konvikte       | 129,783          | 71,332           | 55%        |
| <b>09240</b> | Arsimi mesem profesional                     | 38,478           | 34,746           | 90%        |
| <b>10140</b> | Kujdesi social per personat e semure dhe PAK | 3,443            | 1,797            | 52%        |
| <b>10220</b> | Sigurimi Shoqeror                            | 14,013           | 11,872           | 85%        |
| <b>10430</b> | Kujdesi social per familje dhe femije        | 2,056,861        | 2,019,176        | 98%        |
| <b>10661</b> | Strehimi social                              | 9,714            | 8,264            | 85%        |
| <b>10910</b> | Emergjencat civile                           | 7,636            | 7,012            | 92%        |
| <b>04980</b> | Fondi rezerve & Kontigjenca                  | 10,000           | 0                |            |
|              |  |                  |                  |            |
|              | <b>TOTALI</b>                                | <b>4,987,123</b> | <b>4,088,917</b> | <b>82%</b> |

Realizimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik.

Në mijë lekë

| Emertimi                              | Plan Vjetor 2020 | Fakt Vjetor 2020 | Realizimi ne % krahasuar me planin vjetor |
|---------------------------------------|------------------|------------------|---|
| <b>Paga dhe Sigurime (600-601)</b>    | 1,069,166        | 984,706          | 92%                                       |
| <b>Shpenz.Operative (602-651-166)</b> | 977,361          | 645,350          | 66%                                       |
| <b>Transferta (604-606-609)</b>       | 2,127,561        | 2,039,528        | 96%                                       |
| <b>Investime</b>                      | 813,035          | 419,333          | 52%                                       |
| <b>Totali :</b>                       | <b>4,987,123</b> | <b>4,088,917</b> | <b>82%</b>                                |




Peshën më të madhe të realizimit në përqindje e zënë transfertat në masën 96 % ku përfshihen ndihmat ekonomike, pagesa e personave me aftësi ndryshe, financuar këto nga transfertat e kushtëzuar, si dhe raste të përdorimit të fondit të veçantë, në vlera të papërfillshme duke e krahasuar me totalin e transfertave.

Një zë i rëndësishëm janë shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime), të cilat janë realizuar në masën 92 %, ku përveç pagave të administratës bëjnë pjesë edhe pagat e punonjësve të arsimit parashkollor (edukatorët e kopeshteve), punonjësit e konvikteve, punonjësit mbështetës të arsimit parashkollor dhe të mesëm, shërbimi zjarrfikës, ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, etj, sipas funksioneve të cilat iu deleguan bashkive pas reformës territoriale.

#### **Bazuar në shpenzimet faktike të katërmujorit të tretë (progresiv vjetor 2020):**

- *Shpenzimet për paga zënë 24 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 61 % me burim financim transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 37 % me transfertë specifike dhe 2% me transfertë të kushtëzuar.*
- *Shpenzimet operative zënë 15,8 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 94,5 % me burim financim transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 4,1% me transfertë specifike dhe 1% me transfertë të kushtëzuar. Shpenzimet operative me financim nga fondet jashtë limiti (donacione, financim i Këshilli të Qarkut) janë të papërfillshme dhe zënë më pak se 0,4 % të totalit.*

- *Shpenzimet për transferime zënë 50 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 1,5 % me transfertë të pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta dhe 98,4 % me burim financimi transfertën e kushtëzuar.*
- *Shpenzimet për investime zënë 10,3 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 55,2 % me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 40,3 % me transfertë të kushtëzuar (FZHS), 0,8% me transfertë specifike dhe 3,7 % nga të ardhurat jasht limitit.*



- *Referuar tabelës së mësipërme “Realizimi i buxhetit sipas programeve buxhetore”, shpenzimet e shërbimit të borxhit, për huamarrjen, në krahasim me të ardhurat e përgjithshme zënë 2,8 % dhe 14,9 % në krahasim me të ardhurat e veta.*

**Realizimi i shpenzimeve për 4 Mujorin e III-të, progresiv vjetor 2020 (nga të gjitha burimet e fondeve)**

ne mije leke

|    | Programi / Njesite Shpenzuese      | Programi | Shpenzime personeli |                | Shpenzime operative |                | Transferta       |                  | Shpenzime Kapitale |                | Total buxheti    |                  |
|----|------------------------------------|----------|---------------------|----------------|---------------------|----------------|------------------|------------------|--------------------|----------------|------------------|------------------|
|    |                                    |          | plan                | fakt           | plan                | fakt           | plan             | fakt             | plan               | fakt           | plan             | fakt             |
| 1  | Planifikim, Menax. & Admin.        | 01110    | 276,268             | 251,430        | 101,145             | 61,843         | 30,437           | 17,080           | 14,095             | 11,094         | 421,945          | 341,447          |
| 2  | Çështjet financiare dhe fiskale    | 01120    | 54,760              | 52,785         | 12,514              | 8,300          | 40               | 40               | 0                  | 0              | 67,314           | 61,125           |
| 3  | Sherbime te gjendjes civile        | 01170    | 15,800              | 15,760         | 1,784               | 1,195          | 7,955            | 7,955            | 109                | 0              | 25,648           | 24,910           |
| 4  | Shërbimi i borxhit                 | 01710    | 0                   | 0              | 120,336             | 117,111        | 0                | 0                | 0                  | 0              | 120,336          | 117,111          |
| 5  | Shërbime të Policisë Vendore       | 03140    | 28,180              | 25,977         | 600                 | 97             | 0                | 0                | 612                | 528            | 29,392           | 26,602           |
| 6  | Mbrojtja nga zjarri dhe mb.civile  | 03280    | 29,296              | 29,260         | 17,925              | 17,520         | 37,523           | 1,865            | 2,258              | 952            | 87,002           | 49,597           |
| 7  | Mbeshetjet per zhvill. ekonomik    | 04130    | 1,719               | 1,623          | 86                  | 86             | 0                | 0                | 0                  | 0              | 1,805            | 1,709            |
| 8  | Shërbimi i tregjeve.akred.inspek.  | 04160    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0                | 0                | 4,786              | 0              | 4,786            | 0                |
| 9  | Shërbimet bujq., inspekt.sig.ushq  | 04220    | 13,270              | 12,338         | 400                 | 0              | 0                | 0                | 11,199             | 4              | 24,869           | 12,342           |
| 10 | Menaxhimi infr.Ujitjes& Kullimit   | 04240    | 10,731              | 9,541          | 11,582              | 8,932          | 0                | 0                | 102,378            | 99,323         | 124,691          | 117,796          |
| 11 | Administrimi i pyjeve +kullotave   | 04260    | 20,461              | 13,780         | 15,903              | 933            | 0                | 0                | 20,190             | 90             | 56,554           | 14,803           |
| 12 | Infrastruktura rrugore vendore     | 04520    | 56,189              | 55,724         | 30,152              | 15,316         | 290              | 290              | 294,379            | 97,275         | 381,010          | 168,605          |
| 13 | Transporti Publik                  | 04570    | 19,858              | 19,858         | 29,718              | 13,058         | 42               | 42               | 5,100              | 0              | 54,718           | 32,958           |
| 14 | Menaxhimi I mbetjeve               | 05100    | 9,960               | 9,086          | 133,554             | 76,084         | 0                | 0                | 5,733              | 5,306          | 149,247          | 90,476           |
| 15 | Menaxhimi i ujrave të zeza         | 05200    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0                | 0                | 5,998              | 0              | 5,998            | 0                |
| 16 | Programe te mbrojtjes se mjedisit  | 05320    | 7,820               | 7,620          | 498                 | 463            | 0                | 0                | 100                | 96             | 8,418            | 8,179            |
| 17 | Planifikimi Urban Vendor           | 06140    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0                | 0                | 3,300              | 963            | 3,300            | 963              |
| 18 | Strehimi                           | 06190    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 10,617           | 10,563           | 11,650             | 11,650         | 22,267           | 22,213           |
| 19 | Infrastruktura rajonale vendore    | 06220    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0                | 0                | 33,147             | 33,147         | 33,147           | 33,147           |
| 20 | Sherbime publike vendore           | 06260    | 42,860              | 42,444         | 126,155             | 77,241         | 181              | 181              | 78,619             | 49,397         | 247,815          | 169,263          |
| 21 | Furnizimi me uje                   | 06330    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0                | 0                | 2,778              | 0              | 2,778            | 0                |
| 22 | Ndriçim rrugësh                    | 06440    | 6,621               | 6,620          | 115,765             | 99,865         | 39               | 39               | 17,774             | 6,140          | 140,199          | 112,664          |
| 23 | Sherbimet e kujdesit paresor       | 07220    | 560                 | 560            | 400                 | 292            | 0                | 0                | 0                  | 0              | 960              | 852              |
| 24 | Sport dhe argetim                  | 08130    | 24,686              | 24,042         | 21,128              | 13,983         | 4,074            | 569              | 50                 | 50             | 49,938           | 38,644           |
| 25 | Trasheg.kult.eventet artist.&kult. | 08220    | 42,500              | 40,341         | 29,793              | 14,213         | 360              | 350              | 803                | 782            | 73,456           | 55,686           |
| 26 | Arsimi baze&parashkollor           | 09120    | 303,060             | 270,920        | 126,823             | 69,171         | 720              | 690              | 148,999            | 92,845         | 579,602          | 433,626          |
| 27 | Arsimi mesem pergj. + konvikte     | 09230    | 41,554              | 38,536         | 40,218              | 23,376         | 180              | 180              | 47,831             | 9,240          | 129,783          | 71,332           |
| 28 | Arsimi mesem profesional           | 09240    | 0                   | 0              | 5,270               | 4,062          | 33,208           | 30,684           | 0                  | 0              | 38,478           | 34,746           |
| 29 | Kujd. social pers.semure & PAK     | 10140    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 3,443            | 1,797            | 0                  | 0              | 3,443            | 1,797            |
| 30 | Sigurimi Shoqeror                  | 10220    | 6,883               | 6,542          | 7,130               | 5,330          | 0                | 0                | 0                  | 0              | 14,013           | 11,872           |
| 21 | Kujdesi social per familje&femije  | 10430    | 52,820              | 46,810         | 28,232              | 16,837         | 1,974,962        | 1,955,078        | 847                | 451            | 2,056,861        | 2,019,176        |
| 32 | Strehimi Social                    | 10661    | 3,310               | 3,109          | 250                 | 42             | 5,854            | 5,113            | 300                | 0              | 9,714            | 8,264            |
| 33 | Emergjencat civile                 | 10910    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 7,636            | 7,012            | 0                  | 0              | 7,636            | 7,012            |
| 34 | Fondi rezerve & Kontigjenca        | 04980    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 10,000           | 0                | 0                  | 0              | 10,000           | 0                |
|    | <b>Gjithsej :</b>                  |          | <b>1,069,166</b>    | <b>984,706</b> | <b>977,361</b>      | <b>645,350</b> | <b>2,127,561</b> | <b>2,039,528</b> | <b>813,035</b>     | <b>419,333</b> | <b>4,987,123</b> | <b>4,088,917</b> |

**Shpenzime nga transfertat e pakushtëzuar + të ardhurat për 4 Mujorin e III-të (progresiv vjetor), viti 2020.**

**në mijë lekë**

|                   | Programi / Njesite Shpenzuese                | Programi | Shpenzime personeli |                | Shpenzime operative |                | Transfertat    |               | Shpenzime Kapitale |                | Totali buxhetit  |                  |
|-------------------|--|----------|---------------------|----------------|---------------------|----------------|----------------|---------------|--------------------|----------------|------------------|------------------|
|                   |  |          | plan                | fakt           | plan                | fakt           | plan           | fakt          | plan               | fakt           | plan             | fakt             |
| 1                 | Planifikim, Menax. & Admin.                  | 01110    | 276,268             | 251,430        | 101,145             | 61,843         | 30,437         | 17,080        | 14,094             | 11,094         | 421,944          | 341,447          |
| 2                 | Çështjet financiare dhe fiskale              | 01120    | 54,760              | 52,785         | 12,514              | 8,300          | 40             | 40            | 0                  | 0              | 67,314           | 61,125           |
| 3                 | Shërbimi i borxhit                           | 01710    | 0                   | 0              | 120,336             | 117,111        | 0              | 0             | 0                  | 0              | 120,336          | 117,111          |
| 4                 | Shërbime të Policisë Vendore                 | 03140    | 28,180              | 25,977         | 600                 | 97             | 0              | 0             | 612                | 528            | 29,392           | 26,602           |
| 5                 | Mbrojtja nga zjarri dhe mb.civile            | 03280    | 2,150               | 2,114          | 14,077              | 13,717         | 37,483         | 1,825         | 2,258              | 952            | 55,968           | 18,608           |
| 6                 | Mbeshtetje për zhvillimin ekonomik           | 04130    | 120                 | 38             | 0                   | 0              | 0              | 0             | 0                  | 0              | 120              | 38               |
| 7                 | Shërbimi tregjeve, akred. inspekt.           | 04160    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0              | 0             | 4,786              | 0              | 4,786            | 0                |
| 8                 | Shërbimet bujq. inspekt, sig. ushq           | 04220    | 13,270              | 12,338         | 400                 | 0              | 0              | 0             | 11,200             | 4              | 24,870           | 12,342           |
| 9                 | Menaxh. infr. Ujitjes & Kullimit             | 04240    | 7,143               | 5,954          | 0                   | 0              | 0              | 0             | 15,883             | 12,847         | 23,026           | 18,801           |
| 10                | Administrimi i pyjeve + kullotave            | 04260    | 10,109              | 3,883          | 14,000              | 0              | 0              | 0             | 20,190             | 90             | 44,299           | 3,973            |
| 11                | Infrastruktura rrugore vendore               | 04520    | 43,661              | 43,199         | 24,152              | 9,716          | 218            | 218           | 294,057            | 96,953         | 362,088          | 150,086          |
| 12                | Transporti Publik                            | 04570    | 19,858              | 19,858         | 29,718              | 13,058         | 42             | 42            | 5,100              | 0              | 54,718           | 32,958           |
| 13                | Menaxhimi i mbetjeve                         | 05100    | 9,960               | 9,086          | 133,554             | 76,084         | 0              | 0             | 5,733              | 5,306          | 149,247          | 90,476           |
| 14                | Menaxhimi i ujërave të zeza                  | 05200    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0              | 0             | 5,998              | 0              | 5,998            | 0                |
| 15                | Programe të mbrojtjes mjedisit               | 05320    | 7,820               | 7,620          | 498                 | 463            | 0              | 0             | 100                | 96             | 8,418            | 8,179            |
| 16                | Planifikimi Urban Vendor                     | 06140    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0              | 0             | 3,300              | 963            | 3,300            | 963              |
| 17                | Shërbime publike vendore                     | 06260    | 42,860              | 42,444         | 126,155             | 77,241         | 181            | 181           | 69,487             | 40,265         | 238,683          | 160,131          |
| 18                | Furnizimi me ujë                             | 06330    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 0              | 0             | 2,778              | 0              | 2,778            | 0                |
| 19                | Ndriçim rrugësh                              | 06440    | 6,621               | 6,620          | 115,765             | 99,865         | 39             | 39            | 17,774             | 6,140          | 140,199          | 112,664          |
| 20                | Shërbimet e kujdesit përsos                  | 07220    | 560                 | 560            | 400                 | 292            | 0              | 0             | 0                  | 0              | 960              | 852              |
| 21                | Sport dhe argetim                            | 08130    | 24,686              | 24,042         | 21,128              | 13,983         | 4,074          | 569           | 50                 | 50             | 49,938           | 38,644           |
| 22                | Trashëg. kult. eventet artist. & kult.       | 08220    | 42,500              | 40,341         | 28,429              | 12,849         | 360            | 350           | 803                | 782            | 72,092           | 54,322           |
| 23                | Arsimi baze & parashkollor                   | 09120    | 21,890              | 19,563         | 119,870             | 66,952         | 30             | 30            | 107,468            | 54,911         | 249,258          | 141,456          |
| 24                | Arsimi mesëm përgj. + konvikte               | 09230    | 0                   | 0              | 25,971              | 16,151         | 0              | 0             | 6,671              | 0              | 32,642           | 16,151           |
| 25                | Kujdesi social për personat e semurë dhe PAK | 10140    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 3,443          | 1,797         | 0                  | 0              | 3,443            | 1,797            |
| 26                | Sigurimi Shoqëror                            | 10220    | 4,322               | 4,242          | 7,130               | 5,330          | 0              | 0             | 0                  | 0              | 11,452           | 9,572            |
| 27                | Kujdesi social familje & fëmijë              | 10430    | 31,790              | 25,780         | 27,567              | 16,175         | 9,269          | 3,515         | 741                | 345            | 69,367           | 45,815           |
| 28                | Strehimi Social                              | 10661    | 3,310               | 3,109          | 250                 | 42             | 5,854          | 5,113         | 300                | 0              | 9,714            | 8,264            |
| 29                | Fondi rezerve & Kontigjenca                  | 04980    | 0                   | 0              | 0                   | 0              | 10,000         | 0             | 0                  | 0              | 10,000           | 0                |
| <b>Gjithsej :</b> |  |          | <b>651,838</b>      | <b>600,983</b> | <b>923,659</b>      | <b>609,269</b> | <b>101,470</b> | <b>30,799</b> | <b>589,383</b>     | <b>231,326</b> | <b>2,266,350</b> | <b>1,472,377</b> |

**Shpenzime nga transfertat specifike për 4 Mujorin e III-të (progresiv vjetor), viti 2020**

**në mijë lekë**

| Programi / Njesite Shpenzuese |                                       | Programi | Shpenzime personeli |                | Shpenzime operative |               | Transferta  |             | Shpenzime Kapitale |              | Totali i buxhetit |                |
|-------------------------------|---------------------------------------|----------|---------------------|----------------|---------------------|---------------|-------------|-------------|--------------------|--------------|-------------------|----------------|
|                               |                                       |          | Plan                | Fakt           | plan                | fakt          | plan        | fakt        | plan               | fakt         | plan              | fakt           |
| 1                             | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojt.civile | 03280    | 27,146              | 27,146         | 3,848               | 3,803         | 40          | 40          | 0                  | 0            | 31,034            | 30,989         |
| 2                             | Ujitja dhe kullimi                    | 04240    | 3,588               | 3,587          | 11,582              | 8,932         | 0           | 0           | 0                  | 0            | 15,170            | 12,519         |
| 3                             | Administrimi i pyjeve                 | 04260    | 10,352              | 9,897          | 1,903               | 933           | 0           | 0           | 0                  | 0            | 12,255            | 10,830         |
| 4                             | Infrastruktura vendore rrugore        | 04520    | 12,528              | 12,525         | 6,000               | 5,600         | 72          | 72          | 0                  | 0            | 18,600            | 18,197         |
| 5                             | Arsimi parashkollor dhe baze          | 09120    | 281,170             | 251,357        | 0                   | 0             | 690         | 660         | 0                  | 0            | 281,860           | 252,017        |
| 6                             | Arsimi Mesem pergjith.+konviktet      | 09230    | 41,554              | 38,536         | 14,247              | 7,225         | 180         | 180         | 35,060             | 3,140        | 91,041            | 49,081         |
| 7                             | Mbrojtja sociale                      | 10430    | 21,030              | 21,030         | 0                   | 0             | 78          | 78          | 0                  | 0            | 21,108            | 21,108         |
| <b>Gjithsej :</b>             |                                       |          | <b>397,368</b>      | <b>364,078</b> | <b>37,580</b>       | <b>26,493</b> | <b>1060</b> | <b>1030</b> | <b>35,060</b>      | <b>3,140</b> | <b>471,068</b>    | <b>394,741</b> |



Shpenzime nga transfertat e kushtëzuar për 4 - mujin e III-të (progressiv vjetor), viti 2020

në mijë lekë

| nr              | Institucioni                  | Programi | Shpenzime personeli |               | Shpenz operative |              | Transferta       |                  | Investime      |                | Totali buxhetit  |                  |
|-----------------|-------------------------------|----------|---------------------|---------------|------------------|--------------|------------------|------------------|----------------|----------------|------------------|------------------|
|                 |                               |          | plan                | fakt          | plan             | fakt         | plan             | fakt             | plan           | fakt           | plan             | fakt             |
| 1               | Bashkia Elbasan(QKR)          | 04130    | 1,599               | 1,585         | 86               | 86           | 0                | 0                | 0              | 0              | 1,685            | 1,671            |
| 2               | Gjendje civile                | 01170    | 15,800              | 15,760        | 679              | 679          | 7,955            | 7,955            | 0              | 0              | 24,434           | 24,394           |
| 3               | Ujitja dhe Kullimi            | 04240    | 0                   | 0             | 0                | 0            | 0                | 0                | 86,495         | 86,476         | 86,495           | 86,476           |
| 4               | Strehimi                      | 06190    | 0                   | 0             | 0                | 0            | 10,617           | 10,563           | 11,650         | 11,650         | 22,267           | 22,213           |
| 5               | Infrastrukt. rajonale vendore | 06220    | 0                   | 0             | 0                | 0            | 0                | 0                | 33,147         | 33,147         | 33,147           | 33,147           |
| 6               | Emergjencia civile            | 10910    | 0                   | 0             | 0                | 0            | 7,636            | 7,012            | 0              | 0              | 7,636            | 7,012            |
| 7               | Arsimi bazë                   | 09120    | 0                   | 0             | 6,953            | 2,219        | 0                | 0                | 41,531         | 37,934         | 48,484           | 40,153           |
| 8               | Arsimi mesëm profesional      | 09240    | 0                   | 0             | 5,270            | 4,062        | 33,208           | 30,684           | 0              | 0              | 38,478           | 34,746           |
| 9               | Ndihma ekonomike +PAK         | 10430    | 0                   | 0             | 0                | 0            | 1,959,663        | 1,949,032        | 0              | 0              | 1,959,663        | 1,949,032        |
|                 | Viktimat e dhunes + projekte  | 10430    | 0                   | 0             | 0                | 0            | 5,952            | 2,453            | 0              | 0              | 5,952            | 2,453            |
| <b>Totali :</b> |                               |          | <b>17,399</b>       | <b>17,345</b> | <b>12,988</b>    | <b>7,046</b> | <b>2,025,031</b> | <b>2,007,699</b> | <b>172,823</b> | <b>169,207</b> | <b>2,228,241</b> | <b>2,201,297</b> |

Shpenzime nga të ardhurat jasht limitit për 4 Mujorin e III-të (progresiv vjetor), viti 2020

në mijë lekë

| nr              | Institucioni                          | Programi | Shpenzime personeli |              | Shpenz operative |              | Transferta |          | Investime     |               | Totali buxhetit |               |
|-----------------|---------------------------------------|----------|---------------------|--------------|------------------|--------------|------------|----------|---------------|---------------|-----------------|---------------|
|                 |                                       |          | plan                | fakt         | plan             | fakt         | plan       | fakt     | plan          | fakt          | plan            | fakt          |
| 1               | Sherbime publike vendore              | 06260    | 0                   | 0            | 0                | 0            | 0          | 0        | 9,132         | 9,132         | 9,132           | 9,132         |
| 2               | Trasheg.kult.eventet artistike        | 08220    | 0                   | 0            | 1,364            | 1,364        | 0          | 0        | 0             | 0             | 1,364           | 1,364         |
| 3               | Gjendje civile                        | 01170    | 0                   | 0            | 1,105            | 516          | 0          | 0        | 109           | 0             | 1,214           | 516           |
| 4               | Sigurimi Shoqeror                     | 10220    | 2,561               | 2,300        | 0                | 0            | 0          | 0        | 0             | 0             | 2,561           | 2,300         |
| 5               | Arsimi i mesem                        | 09230    | 0                   | 0            | 0                | 0            | 0          | 0        | 6,100         | 6,100         | 6,100           | 6,100         |
| 6               | Infrastruktura rrugore                | 04520    | 0                   | 0            | 0                | 0            | 0          | 0        | 322           | 322           | 322             | 322           |
| 7               | Kujdesi social per familje dhe femije | 10430    | 0                   | 0            | 665              | 662          | 0          | 0        | 106           | 106           | 771             | 768           |
| <b>Totali :</b> |                                       |          | <b>2,561</b>        | <b>2,300</b> | <b>3,134</b>     | <b>2,542</b> | <b>0</b>   | <b>0</b> | <b>15,769</b> | <b>15,660</b> | <b>21,464</b>   | <b>20,502</b> |


## Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta vendore.

Këto burime të ardhurash zënë një vënd kryesor në buxhetin e bashkisë pasi financojnë pothuajse të gjitha funksionet në administrim të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe përbëjnë 45% të totalit të buxhetit.

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2020, për shkak të situatës së pandemisë, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi në mënyre racionale burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e funksioneve bazike dhe veçanërisht atyre sociale gjatë muajve mars dhe prill.

Totali i shpenzimeve buxhetore të realizuara me burimet e veta, krakasuar me planin vjetor është 65%, pagat janë realizuar në masën 92%, shpenzimet operative 66%, transferimet në masën 30% dhe investimet në masën 39%.

| Emertimi                 | Plan vjetor 2020 | Fakti vjetor 2020 | Realizimi në % |
|--------------------------|------------------|-------------------|----------------|
| <b>Paga dhe Sigurime</b> | 651,838          | 600,983           | 92%            |
| <b>Shpenz.Operative</b>  | 923,659          | 609,269           | 66%            |
| <b>Transferime</b>       | 101,470          | 30,799            | 30%            |
| <b>Investime</b>         | 589,383          | 231,326           | 39%            |
| <b>Totali</b>            | <b>2,266,350</b> | <b>1,472,377</b>  | <b>65%</b>     |





**Fondi rezervë** në buxhetin fillestar të vitit 2020 është planifikuar në shumën 8,000 mijë lekë, ndërsa fondi kontigjencës 10,000 mijë lekë. Gjatë tremujorit të tretë, në muajin tetor, fondi rezervë është transferuar me vendim të KB për rritjen e shpenzimeve të ndriçimit rrugor, pasi me investimet e realizuara gjatë vitit 2020 janë rritur ndjeshëm zonat që mbulohen me ndriçim rrugor, janë shtuar kontratat e energjisë elektrike me FSHU – në, për rrjedhojë është rritur fuqia e instaluar për llogari të ndriçimit rrugor duke bërë që të kishim shtesë të faturimeve, çka bëri që fondi i shpenzimeve i parashikuar në buxhetin e vitin 2020 për ndriçimin rrugor të mos ishte i mjaftueshëm për likuidimin e faturave deri në muajin dhjetor.

❖ **Fondi i emergjencave civile**, në buxhetin fillestar të vitit 2020 është planifikuar në shumën 60,000 mijë lekë dhe gjatë vitit 2020 është përdorur në shumën **1,826 mijë lekë** me vendime të Këshillit Bashkiak për dëmtime banesash, shkaktuar nga fatkeqsi natyrore si: rrëshqitje të tokës, erëra të forta dhe për dëmtime nga rënia e zjarrit, në shumën **13 316 mijë lekë** transferuar me vendim të Këshillit Bashkiak në muajin prill për “Blerje produkte ushqimore dhe jo ushqimore, për familjet në nevojë, si pasojë e situatës së krijuar nga “Covid -19”, në shumën **270 mijë lekë** për “Dhënie e ndihmës ekonomike të dyfishuar” për shkak të situatës së pandemisë, me vendim të KB në muajin shtator për “Dezinfektimin e ambjenteve shkollore: kopështe, çerdhe dhe shkolla, në Bashkinë Elbasan, në kuadër të masave anticovid-19”, për shumën **10,731 mijë lekë**, gjithsej është përdorur për shumën 26 143 mijë lekë.

### **Në lidhje me investimet nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar :**

Sipas detajimit të buxhetit dhe depozitimit në sistemin e Thesarit, janë planifikuar 85,977 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar, 57,983 mijë lekë nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2019, nga të ardhurat e vitit 2020 janë 355,049 mijë lekë dhe të ardhura nga huaja 90 374 mijë lekë, gjithsej 589, 383 mijë lekë.

Siç e shikojmë kemi 24 % të totalit të investimeve të cilat financohen me transfertë të pakushtëzuar dhe të ardhura të trashëguara, të cilat janë burime fondesh të garantuara. Rreth 60 % e investimeve financohen nga të ardhurat e vitit, duke bërë që prokurimi dhe realizimi i tyre të varet shumë nga arkëtimi dhe realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore dhe 15 % zënë shpenzimet për shpronësime nga huaja.

Realizimi me 39 % si 12 mujor i zërit të investimeve, duke e krahasuar me planin vjetor, ka të bëjë siç u shprehëm edhe më lart, me problemet në arkëtimin e të ardhurave, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia, por edhe me investimet (shpronësimet) nga huaja të cilat nuk janë realizuar për mungesë të dokumentacionit për shpronësim. Duke mos marrë në konsideratë huanë, realizimi për vitin 2020, i zërit të investimeve, duke e krahasuar me planin vjetor është 46 %.

## Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën specifike.

Në vitin 2020 Bashkia vazhdon të kryejë funksionet e transferuara me burim financimi transfertën sektoriale (specifike). Funksionet që u transferuan në Bashki janë:

### ❖ **Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.**

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Për arsimin parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në qendrën kulturore të fëmijëve), janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 252 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (parashollor dhe Qendra kulturore e fëmijëve) janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 116 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm, janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 57 punonjës të transferuar.

### ❖ **Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)**

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë alokuar fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Numri i punonjësve është 31. Bashkia ka financuar nga të ardhurat e veta për blerje pajisje specifike për zjarrfikëset, në zërin investime, për shumën 952 mijë lekë.

### ❖ **Administrimi i pyjeve**

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond perfshihen shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2020 numri i punonjësve është 15.

Bashkia Elbasan në strukturën organizative të saj, ka krijuar Drejtorinë e Pyjeve, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, në të cilën bën pjesë sektori i pyjeve, i cili merret me administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Gjithashtu, meqenese fondet nga transferta sektoriale janë te pamjaftueshme për këtë shërbim, Bashkia Elbasan ka financuar nga të ardhurat e veta në zërin paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime, për të siguruar mbarëvajtjen e këtij shërbimi.

#### ❖ **Rrugët rurale**

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Fondet e alokuara nga kjo transfertë janë të pamjaftueshme për të financuar të gjithë zërat e shpenzimeve të domosdoshëm për këtë funksion. Në këto kushte Bashkia Elbasan ka financuar nga të ardhurat e veta në zërin paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime, për të siguruar mbarëvajtjen e këtij shërbimi.

#### ❖ **Ujitja dhe Kullimi**

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond përfshihen fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2020 numri i punonjësve është 5. Ky shërbim është i atashuar në Agjensinë e Shërbimeve Publike, Sektori i Kullimit dhe Vaditjes. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka Ujitja dhe Kullimi, Bashkia Elbasan ka financuar nga fondet e veta si në shpenzime personeli, nëpërmjet punëtorëve sezonale, ashtu dhe në investime, për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tokës

#### ❖ **Konviktet e arsimit parauniversitar**

Në transfertën specifike të vitit 2020, Bashkisë Elbasan i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë janë të përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzime operative dhe shpenzime për investime.


#### ❖ **Qendrat e Shërbimeve Sociale**

Në transfertën specifike të vitit 2020 për Bashkinë Elbasan janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për Qendrën Sociale “Balashe” Elbasan. Edhe në këtë rast Bashkia Elbasan ka financuar nga fondet e veta në shpenzime personeli, operative dhe investime.

Gjithashtu në këtë qendër kryejnë aktivitetin e tyre “Qendra Rome” dhe “Shtëpia e të Moshuarve”, të cilat Bashkia Elbasan i financon nga fondet e veta.

Në totalin e shpenzimeve me burim financimi transfertën specifike, realizimi në krahasim me planin vjetor është 84%. Pagat janë realizuar me 92%, shpenzimet operative me 70 % dhe transfertat 97%. Përsa i takon investimeve realizimi në krahasim me planin vjetor është 10%, i cili faktikisht i takon 4- mujorit të tretë pasi për 4 mujorin e parë dhe të dytë 2020 nuk kishim realizim të këtij zëri shpenzimesh meqenëse procedurat e prokurimit u pezulluan nga APP si pasojë e situatës së pandemisë, krijuar nga “Covid -19”.

|                          | <i>Plani vjetor</i> | <i>Fakti vjetor</i> | <i>Realizimi ne %</i> |
|--------------------------|---------------------|---------------------|-----------------------|
| <b>Paga dhe Sigurime</b> | 397,368             | 364,078             | 92%                   |
| <b>Shpenz.Operative</b>  | 37,580              | 26,493              | 70%                   |
| <b>Transferime</b>       | 1,060               | 1,030               | 97%                   |
| <b>Investime</b>         | 35,060              | 3,140               | 10%                   |
| <b>Totali :</b>          | <b>471,068</b>      | <b>394,741</b>      | <b>84%</b>            |



## Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e kushtëzuar.

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, që në fakt zënë 89 % të totalit të transfertës së kushtëzuar ose 1,949,032 mijë lekë, si dhe fonde për bursat e nxënësve, bonuse strehimi, mbështetje për viktimat e dhunës, etj. te cilat zënë 2,3 % të totalit të transfertës së kushtëzuar ose 49,981 mijë lekë.

Gjithashtu, pjesë e transfertës së kushtëzuar janë edhe investimet në arsimin 9-vjecar, strehimin e komunitetit Rom, si dhe në infrastrukturën rajonale vendore, nëpërmjet investimeve nga FZSHH, gjithsej në shumën 172,823 mijë lekë plan dhe fakt 169,207 mijë lekë.

| Emertimi  | Plan vjetor 2020 | Në mijë lekë |                                  |
|---|------------------|--------------|----------------------------------|
|   |                  | N            | Fakt Vjetor 2020<br>(4-M III-të) |
| QKR   | 1,685            | m            | 1,671                            |
| Gjendja Civile  | 24,434           | j            | 24,394                           |
| Trajtim ushqimor (bursat e nxenesve)                  | 45,431           | ä            | 36,965                           |
| “Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare “Jorgj Dilo”     | 37,934           |              | 37,934                           |
| “Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare “Bardhyl Popa”   | 3,597            |              | 0                                |
| Bonus trehimi   | 10,617           |              | 10,563                           |
| Invaliditet+Paaftesia+Nd.Ekon                         | 1,959,663        |              | 1,949,032                        |
| Viktimat e dhunes + projekte mbrojtjes sociale        | 5,952            |              | 2,453                            |
| “Rikonstruksion asfaltim rruga Funar- Mollagjesh”     | 33,147           |              | 33,147                           |
| “Sistemim perroi I zaranikes “                        | 86,495           |              | 86,476                           |
| “Përmiresimi i kushteve te banimit te kumuniteteve te | 11,650           |              | 11,650                           |
| Emergjencia civile                                    | 7,636            |              | 7,012                            |
| <b>Totali :</b>                                       | <b>2,228,241</b> |              | <b>2,201,297</b>                 |


Siç shikohet edhe nga të dhënat në tabelën e mësipërme, “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare “Jorgj Dilo”, “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare “Bardhyl Popa”, “Rikonstruksion - asfaltim rruga Funar – Mollagjesh” dhe “Përmiresimi i kushteve të banimit të kumuniteteve” janë objekte në vazhdim nga viti 2018, financim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZSHH-së. Investim i konsiderueshëm për vitin 2020 është objekti “Sistemin përroi i Zaranikës”, investim i cili eviton dhe mbron qytetin e Elbasanit nga përmbytjet në periudhën e shirave.



## Shpenzime nga transferta e kushtëzuar :

ne 000/leke

|                          | Plani Total      | Fakti 8 M        | Realizimi ne % |
|--------------------------|------------------|------------------|----------------|
| <b>Paga dhe Sigurime</b> | 17,399           | 17,345           | 99%            |
| <b>Shpenz.Operative</b>  | 12,988           | 7,046            | 54%            |
| <b>Transferime</b>       | 2,025,031        | 2,007,699        | 99%            |
| <b>Investime</b>         | 172,823          | 169,207          | 98%            |
| <b>T</b>                 | <b>2,228,241</b> | <b>2,201,297</b> | <b>99 %</b>    |



Në totalin e shpenzimeve me burim financimi transfertën e kushtëzuar realizimi për vitin 2020, krahasuar me planin vjetor është 99% ose 2,201,297 mijë lekë. Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 99%, në zërin shpenzime operative 54%, transferimet ku bëjnë pjesë paaftësia dhe ndihma ekonomike në masën 99% dhe investimet në masën 98%.

Bashkia Elbasan, ka treguar kujdes dhe përparësi në realizimin e investime, të cilat janë likuajduar fakt në masën 98%.

#### ❖ Shpenzime (investime) me të ardhurat nga huaja.

Një zë të vecantë në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të Bashkisë Elbasan zë huaja për shpronësime dhe investime në infrastrukturën rrugore, bazuar në marrëveshjen datë 29.09.2010, marrëveshjen e interceptimit nr.2544/1, datë 29.09.2010 dhe në aneks-marrëveshjen nr.751/1, datë 26.05.2014, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe BKT.

Shuma totale e huasë së miratuar, pas rishikimit, sipas aneks –marrëveshjes, është 711 milion lekë.

Shuma e disbursuar gjithsej është 621 milion lekë, e cila është përdorur për shpronësime dhe pjesërisht për investime në infrastrukturën rrugore. Mbeten për disbursim 90 milion lekë, pjesë e buxhetit të miratuar për vitin 2020.

Sipas buxhetit të miratuar për vitin 2020, janë planifikuar të ardhura nga huaja 90 milion lekë dhe shpenzime për shpronësime dhe investime në infrastrukturën rrugore po 90 milion lekë. Gjatë periudhës janar- dhjetor 2020 nuk kemi disbursime të reja, pra gjendja e disbursuar është e barabartë me fundin e vitit 2019. Disbursimi e kësaj shume është në varësi të plotësimin të dokumentacionit nga ana e ish pronarëve.

Nga shuma e huasë së disbursuar Bashkia Elbasan ka shlyer rregullisht këstet e shërbimit të borxhit (principal +interes), çdo muaj, bazuar në planin e pagesave të bankës.

Të dhëna mbi huamarrjen e Bashkisë Elbasan.

Në mijë lekë

|                   | Shuma          | Sherbimi i borxhit te paguar deri me 31.12.2020 |          |                 | Sherbimi i borxhit per tu paguar deri ne maturim |          |                 |
|-------------------|----------------|---|----------|-----------------|--|----------|-----------------|
|                   |                | principal                                       | interesa | <b>gjithsej</b> | principal  | interesa | <b>gjithsej</b> |
| Hua e disbursuar  | 620,773        | 343,328   | 169,264  | <b>512,592</b>  | 277,446  | 30,422   | <b>307,868</b>  |
| Hua pa disbursuar | 90,353         |   |          |                 |  |          |                 |
| <b>Gjithsej :</b> | <b>711,126</b> |   |          |                 |  |          |                 |

Më poshtë po përmendim disa nga programet më kryesore në zërat e buxhetit.

✓ **Programi i Administratës Vendore (Planifikim Menaxhim, Administrim)**

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të punës, veçanërisht në vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e institucionit për të mundur përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrit ligjor në funksion.

Qeverisja jonë lokale bazohet në parimet e sundimit të ligjit, përgjegjësisë, llogaridhënies, besimit, transparencës, efektivitetit, efikasitetit, partneritetit dhe koherencës.

Meqënëse qeverisja e mirë ndërlihet me aftësinë e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mirë për komunitetin, çdo anëtar është aktiv për të dhënë kontributin e tij. Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë si lehtësuese duke iu prirë qytetarëve:

- drejt të menduarit strategjik,
- duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,
- duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve.

Politikat e vazhdueshme, të cilat do të zbatohen nga administrata e Bashkisë Elbasan, janë :

- I. Një strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për përthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë Elbasan, për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
- II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.
- IV. Dixhitalizmi i administratës publike është dhe do të mbetet një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore.

Ne jemi të angazhuar për të shtuar dhe promovuar shërbimet elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore. Është realizuar ofrimi i shërbimeve administrative elektronike ndaj qytetarëve në Bashkinë Qendër dhe në Njësitë Administrative.

## ✓ **Programi i Infrastrukturës Rrugore**

### **Politikat e zhvillimit**

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses më të mirë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare. Programi i infrastrukturës rrugore, bazohet në 2 politika themelore :

- Përmirësimin e mjedisit urban me standartet e duhura në shërbim të komunitetit.
- Rritjen e cilësisë dhe sigurisë së jetës së banorëve.

Objektivat kryesorë të këtij programi janë :

1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;
2. Përmirësim i infrastrukturës rrugore si dhe te rritje e aksesit ndaj shërbimeve bazë në zonat rurale.
3. Përmirësim i sigurisë në rrugët e Bashkisë së Elbasanit.
4. Mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të Bashkisë.
5. Reduktim i kostove për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe përdorimit të fuqisë punëtore të njësisive administrative.

Në buxhetin e vitit 2020, shpenzimet për investime në programin e Infrastrukturës Rrugore, Ujitjes dhe Kullimit dhe Infrastruktura Rajonale Vendore zënë peshën më të madhe në totalin e buxhetit, me rreth 5,6 %, ose 229,745 mijë lekë.

## ✓ Programet për Shërbimet Publike

Programi i ofrimit të shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrative të Bashkisë përbën një nga kolonat kryesore të programit buxhetor.

Ky program përmban shërbimet më jetike për komunitetin siç janë:

- a) mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane,
- b) mirëmbajtja dhe administrimi i sipërfaqeve të gjelberta,
- c) mirëmbajtja e varrezave publike dhe krijimi i kushteve sipas standartave për shërbimin funeral,
- d) shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike,
- e) mobiliteti dhe transporti nëpërmjet krijimit të lehtësirave të lëvizjes, krijimin e kushteve për transportin publik,
- f) realizimi sipas standarteve të sinjalistikës rrugore.

Shërbimet publike, për nga rëndësia e tyre, ndikojnë direkt në cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe janë një parakusht për zhvillimin social ekonomik për të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Programi i shërbimeve publike, bazohet në tre politika themelore :

1. Ofrimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.
2. Rritja e efiçensës të teknologjisë si dhe zgjerimit të shërbimit nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm
3. Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.

### **Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane**

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke sunuar drejt ndarjes në burim të atyre të riciklueshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor që bën të mundur përmirësimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill. Në buxhetin e vitit 2020 ka një rritje e shpenzimeve për shërbimin e pastrimit, krakasuar me periudhën deri në vitin 2019, duke shtuar zonat e mbuluara me këtë shërbim por edhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimit të ofruar.

## **Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike**

Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, në të gjithë Bashkinë.

## **Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit**

Synohet për një shërbim cilësor me standarte sipas normativave dhe rregullores së mirëmbajtjes së varrezave nëpërmjet hartimit të një plani të integruar për funksionimin e Varrezave Publike. Gjithashtu synohet zgjerim i territorit të Varrezave Publike për vazhdimësinë e këtij shërbimi, nëpërmjet shpronësimeve. Nëpërmjet punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve Publike është realizuar shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave në Njësitë Administrative.

### **✓ Ndriçimi i mjediseve publike**

Objektivat për këtë shërbim janë :

#### **Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit**

1. Mirëmbajtje e ndriçuesve të zakonshëm ekzistues
2. Mbajtja në efikasitet e ndriçimit të lulishteve ekzistuese.
3. Mbajtja në efikasitet e ndriçimit rrugor
4. Mirëmbajtja e gjithë rrjetit të ndriçimit rrugor.
5. Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 12 Njësitë Administrative dhe ndërtimi i linjave të reja me prioritet zonat e populluara.

Ndërhyrjet rehabilituese janë realizuar nga Agjencia e Shërbimeve Publike përgjatë gjithë vitit pasi është siguruar me pare baza materiale e nevojshme dhe janë hartuar projektet. Me zbutjen e masave ndaj pandemisë dhe lejimit nga APP për nisjen procedurave të prokurimit janë realizuar një sërë projektesh nga të cilët përmëndim : “Blerje ndriçues me gjithë krahë”, “Blerje ndriçues led me dy krahe”, “Blerje shtylla ndriçimi për linjat elektrike”, “Blerje tel ABC + kabllo (4\* 6mm ; 4\*10mm)”, etj. Me rëndësi është të përmëndim investimin për ndriçimin e qendrave të Njësive Administrative, projekt në vazhdim nga vitet e kaluara.

## ✓ Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave

Pyjet kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet sigurimit të mirëqenies njerëzore, sigurojnë një mjedis të shëndetshëm dhe mbështesin zhvillimin ekonomik të zonës në tërësi. Potenciali unik i pyjeve mbështet një ekonomi të gjelbër, rrit cilësinë e jetës dhe ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Sfida për të realizuar këtë balancë të qëndrueshme mjedisore është e madhe dhe e vështirë referuar edhe larmishmërisë së territorit dhe problematikave që mbart sejcili sistem territorial.

### **Politikat e zhvillimit**

Programi i Mjedisit dhe Mbrojtjes së Pyjeve e Kullotave mbështetet në këto politika themelore :

Mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve, përmes bashkëpunimit me komunitetin e Bashkisë e shoqërinë civile. Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, gjithpërfshirjes në fushën e mbrojtjes së natyrës në bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale dhe jo vetëm, për ndalimin e humbjes së biodiversitetit por edhe përmirësimit të statusit të tyre.

Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujrave sipërfaqësore, lumenjve dhe ujrave nëntokësorë, etj. Shfrytëzimin racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

Zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimit dhe aftësisë ripërtëritëse të pyjeve, si dhe parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

Realizimin e mbrojtjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullimore nëpërmjet një qeverisjeje më të mirë të fondit për Administrimin e Pyjeve.

Hartim i projekteve teknike për pyllëzim të sipërfaqeve pyjore si dhe rehabilitim i sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni nëpërmjet investimeve për mbrojtjen e tokës.

## ✓ **Programi i Arsimit parauniversitar dhe edukimit**

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmije që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Elbasan duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucionesh arsimore për 12 njësitë administrative. Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan. Në kuadër të reformës së re administrative të qeverisjes vendore janë pjesë e këtij programi edhe delegimi i funksioneve të reja si: Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve, punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjecar, punonjësit e shërbimeve mbështetëse të arsimit të mesëm.

### **Politikat e zhvillimit**

Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në të gjithë territorin, për institucionet e edukimit parauniversitar dhe atij parashkollor gjatë procesit të realizimit të programit mësimor vjetor.

Përmirësimi i sistemeve të edukimit dhe trajnimit profesional dhe ndërlidhja e politikës arsimore me politikën social-ekonomike.

Mbështetja dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i rezultateve të larta në shkollë. Promovimi dhe nxitja e hapjes së strukturave të edukimit jashtë orarit mësimor, për të plotësuar një nga të drejtat bazë të fëmijëve, siç është argëtimi, loja, sporti etj

Përmirësimi i kushteve dhe standarteve të shkollave nëpërmjet ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, për zhvillimin e procesit mesimor edukativ në kushte të përshtatshme në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Elbasan.

Përmirësimi i shërbimit të ngrohjes me qëllim krijimin e kushteve për funksionimin dhe zhvillimin sa më normal të procesit mësimor.

Sigurimin e standarteve për sigurimin e higjenës për: konviktet, shkollat, kopështet, magazina, etj.



Përmirësimi i kushteve me anë të sigurimit të bazës materiale për shërbimet mbështetëse, me qëllim funksionimin sa më normal të objekteve shkollore (shkolla, kopështe, konvikte).

Specifikisht për vitin 2020, për shkak të situatës së krijuar nga “COVID-19”, është punuar për krijimin e kushteve për zhvillimin e mësimin me turne në disa nga objektet shkollore, për disa nivele të mësimdhënies.

Rritja e sigurisë në ambjentet shkollore nëpërmjet shërbimit të rojeve të sigurisë publike dhe monitorimit me anë të sistemit të kamerave.

Dezinfektimin e abienteve shkollore, si një domosdoshmëri dhe detyrim ligjor në kushtet e pandemisë “COVID-19”.